



K.DH.SH.II.nr.1015/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Ramush Bardiqi, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NT “V...I...I...” Sh.P.K me seli në Suharekë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2641/18, të datës 02.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 30.03.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit NT “V...I...I...” Sh.P.K me seli në Suharekë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2641/18, të datës 02.06.2021, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit NT “V...I...I...” Sh.P.K me seli në Suharekë, me të cilën ka kërkuar që të anulohet aktvendimi nr.01.3.2.2/545 datë 04.10.2018 i Doganës së Kosovës në Prishtinë dhe që të detyrohet e paditura që paditësit t’ia kthej shumën prej 8,8416.60€ me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e ngritjes së padisë e deri në pagesën definitive dhe ka lënë në fuqi aktvendimin me nr.01.3.2.2/545 të datës 04.10.2018 të Doganës së Kosovës në Prishtinë. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të: konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, shkelje të dispozitave të procedurës dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e paditësit NT “V...I...I...” Sh.P.K me seli në Suharekë dhe të ndryshoj aktgjykimin A.nr.2641/18, të datës 02.06.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative/ Divizioni Fiskal, ose lënda kthehet në rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h, të Ligjit,nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63.2 të LKA, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

- Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin nr. 01.3.2.2/545 të datës 04.10.2018 ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën e subjektit në procedurë NT “V...I...I...” Sh.P.K me seli në Suharekë për rishqyrtimin e vendimit Nr. R-7455 të datës 23.08.2018 të ZD Dheu i Bardhë-Terminal si e pa bazuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ-Divizion Fiskal për këtë çështje ka mbajtur seancë me datë 02.06.2021 ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ gjyqësor në ri procedurë në pajtim me dispozitat e nenit 41 të LKA-së në mungesë të palëve ndërgjyqëse dhe pas administrimit të provave gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur dhe vërtetimit të gjendjes faktike, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, ndërsa e len në fuqi aktvendimin e organit të paditur nr. 01.3.2.2/545 të datës 04.10.2018, sipas theksimeve si në arsyetim ndër të tjera se: Nga arsyetimi i vendimit kontestues gjykata konstaton se e paditura ka theksuar se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport, përkatësisht import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së, subjekti nuk ka arritur të prezantoj dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar për të dëshmuar se vlera e deklaruar është vlerë reale e transaksionit pasi nuk ka prezantuar kontratën e shitblerjes që do të caktonte llojin e mallit, çmimin e mallit si dhe kushtet e dërgesës dhe të pagesës. Në rastin konkret nga ekzaminimi i provave në shkresat e lëndës nga paditësi nuk është dëshmuar se vlera e deklaruar e mallit është çmimi realisht i paguar, ku paditësi në këtë procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ për të provuar vlerën e deklaruar të mallit lëndor me DUD-in me nr.R-7455 të datës 23.08.2018 të ZD Dheu i Bardhë Terminal, ka paraqitur si provë faturën e blerjes se mallit të lëshuar nga eksportuesi me nr.18/111 të datës 09.05.2018 në shumë prej 133,000.00€, kontratën e shitblerjes lidhur me eksportuesin të datës 09.05.2018 si dhe transaksionin bankar të datës 16.08.2018 në shumë prej 138,000.00€ me përshkrim bankar “pagesë për vinç” shumë kjo të cilin gjykata nuk ka mundur ta harmonizoj me vlerën e deklaruar të mallit lëndor me DUD-in me nr. R-7455 të datës 23.08.2018 ku vlera e deklaruar e mallit nga paditësi ka qenë në shumë prej 133,000.00€ për mallin e deklaruar me DUD kontestues pa përfshirë shpenzimet e transportit të cilat kanë qenë të deklaruar në shumë prej 12,000.00€. Nga kjo gjendje e fakteve, gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga ajo të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se paditësi as në procedurë administrative tek e paditura, por as para gjykatës në këtë konflikt administrativ, nuk ka dëshmuar me dokumentacion të nevojshëm për përcaktimin e vlerës doganore të mallrave në bazë të metodës së parë të vlerësimit, në pajtim me nenin 33 par.1 të KDAK-së, e të cilat dokumente është obligim i paditësit-deklaruesit të mallit lëndor t’ia bashkëngjisë Deklaratës Unike Doganore. Së këndejmi, gjykata konstaton se paditësi në këtë rast nuk ka dëshmuar vlerën e transaksionit, përkatësisht

nuk ka dëshmuar çmimin vërtetë të paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç kërkohet me nenin 33 par. dhe 3 të KDA-së.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë. Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i kësaj gjykate, vlerëson se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje sipas pretendimeve ankimore, as me shkelje qenësore të dispozitave të LKA-së, dhe të LPK-së, të cilat kolegji i vlerëson sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar- aktvendimit të Doganës së Kosovës, të atakuar nga paditësi si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA, me të cilin aktvendim në procedurë administrative e gjithashtu edhe në procedurë gjyqësore sipas aktgjykimit të atakuar me ankesë, në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se paditësi nuk ka dëshmuar me dokumentacion adekuat dhe bindës për tu dëshmuar vlera reale e paguar për mallin lëndor, dhe për tu bërë zhdoganimi sipas DUD të lartcekur me metodën e parë (neni 33 të KDA), andaj me të drejtë nga Dogana e Kosovës i është kontestuar vlera e deklaruar e mallit për zhdoganim, pasi që vlera e mallit të deklaruar nuk është vlera reale e paguar për mallin me qëllim të eksportit në vendin tonë. Kolegji njëjtë si gjykata e shkallës së parë, vlerëson se Dogana e Kosovës, bazuar në faktet e cekura si më lartë me të drejtë ka aplikuar metodën e 6 (gjashtë) të vlerësimit, neni 35 i KDA-së nr.03/L-109, në bazë të dhënave të disponueshme të marra nga interneti, respektivisht çmimet për mallin e ngjashëm nga faqja e internetit www..... fakt ky vendimtar i cili ka ndikuar që edhe malli lëndor i paditësit të vlerësohet sipas këtij çmimi.

Pretendimet ankimore të ankuesit nga shkaqet e cekura si më lart, kolegji i refuzon si të pa bazuara dhe jo me ndikim për vendosjen e çështjes në mënyrë tjetër, nga ajo që është vendosur në gjykatën e shkallës së parë, sepse nuk dëshmohet se gjykata e shkallës së parë gjatë vendosjes ka bërë cenim të dispozitave procedurale, e po ashtu gjendja faktike e çështjes gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së Aktvendimit të organit të paditur është vërtetuar në mënyrë të plotë. Pretendimi i paditësit se posedon të gjithë dokumentacionin përcjellës për blerjen e mallit dhe se mallin e ka transportuar në mënyrë korrekte, duke dëshmuar me dokumentacion valid siç është fatura, transaksioni bankar, deklarata e transportit, kontrata, etj. dhe ka pritur nga gjykata një vlerësim real, dhe jo një konstatim të gabuar të gjendjes faktike. Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se dëshmitë në të cilat thirret në ankesë paditësi, vërtetohet se nga gjykata e shkallës së parë janë shqyrtuar në tërësi, por nuk është arrit të dëshmohet se janë prova të qëndrueshme dhe bindëse materiale, për tu dëshmuar vlera reale e mallit, andaj për shkak të metave të tyre nuk janë pranuar si të vlefshme, sepse nuk është dëshmuar vlera reale e mallit lëndor, sipas DUD kontestues.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i

kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVË
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1015/22, me datë 30.03.2023

Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami